



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:134129

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05431874

NË EMËR TË POPULLIT

P.2023:134130

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, me procesmbajtësen Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit N.I i shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK–së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 791/2023 të datës 14.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 04.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdulla Abedini, të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: N.I nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut i lindur me datë ..., nga babai H... dhe nëna L..., e gjinisë T..., ka të kryer shkollën e Mesme, i martuar prind i 4 fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme, me numër personal :..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 29.05.2023, rreth orës 19:30, në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri”, si park i mbrojtur, saktësisht në njësinë menaxhuese - Ahishta, vendi i quajtur “Llageri”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjell përfitim

pasuror të kundërligjshëm në atë mënyrë që ka vjedhur sasinë drusore **1.10m³ të llojit Ahu**, të cilën e ka ngarkuar në mjetin transportues të markës "...", me tabela të regjistrimit ..., duke i shkaktuar dëm material Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" në shumë prej 455.00 €.

-Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 45, 46, 57, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364, 452, 462 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON

I.1 Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditëve (Gjashtëdhjetë ditëve), i cili në bazë të nenit 45 paragrafi 1 të KPPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme - 150 (Njëqind e pesëdhjetë dhjetë) orë pune, të cilin punë në dobi të përgjithshme i pandehuri do ta përfundoj në afat prej 3 (tre) muajve, prej ditës së fillimit të ekzekutimit të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 45 paragrafi 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Republikës së Kosovës cakton llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Konform nenit 45 paragrafi 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 8 orë të punës së pa përfunduar me 1 ditë burgim;

I.2. Dënim me gjobë në shumë 100€ (Njëqind euro), të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të

kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t'ia paguaj dëmin në vlerë 455€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. Obligohet i pandehuri që për shpenzimet procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën P/II.nr. 791/2023 të datës 14.06.2023ndaj të pandehurit për shkak të veprës Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së me të cilën i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe të njëjtit t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale, me të cilën do të arrihej qëllimi i dënimit.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, ka caktuar dhe zhvilluar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.03.2024.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka deklaruar me vjen keq që ka ndodhur kjo ka qenë hera e parë dhe e fundit dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsërisë vepra tjera

penale dhe ka dhënë pëlqimin për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me pune në dobi të përgjithshme.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale për të cilën është akuzuar në bazë të kësaj aktakuze pasi që një pranim të tillë e bëri vullnetarisht, pranimi i fajësisës u bë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj komform ligjit sa i përket llojit të lartësisë së dënimit gjykata të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese ashtu që me seksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, është penduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të

përsëris vepra penale në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-ës, gjykata ka vendosur që të pandehurit ti obligoj që t'ia paguaj palë së dëmtuar dëmin në vlerë 455€, duke u bazuar në Fletëparaqitja e rojtarit të natyrës në të cilën është bërë llogaritja në kubaturë e drunjëve të prera si dhe vlera e dëmit, ku si pjesë e saj është edhe procesverbali i komisionit të ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit, e llogaritur sipas çmimoreve të përcaktuara në rregulloren e MMPH Nr.1-15 për shërbimet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucioneve të sajë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:134130, më datë 11.03.2024

Procesmbajtësja:

Indira Beqa

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.